

Emër Mbiemër **APOLLON BAÇE**
Datëlindje **12.1943**
Vendlindje **Tiranë**
Viti i zgjedhjes **2008**
Seksioni **Shkencat shoqërore dhe albanologjike**



Kontakt

Adresa:

Telefon:

Email: apollon.bace@akad.gov.al

apollonbace@gmail.com

Faqe zyrtare: www.akad.gov.al

CV e shkurtër

Arkeolog, publicist, profesor, akademik. Kreu studimet e larta në degën histori-gjeografi të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në UT (1968); në vitin 1968–1993 dhe 2005–2007 punonjës shkencor në *Institutin e Monumenteve të Kulturës*, ku ishte dhe përgjegjës i sektorit të Antikitetit dhe të Mesjetës (1976–1988), drejtor i IMK (2005–2007) dhe kryeredaktor i revistës “*Monumentet*”. Ka kryer gërmime arkeologjike dhe restaurime në qendrat antike: *Sofratikë, Paleokastër, Butrint* dhe ato mesjetare: *Berat, Gjirokastër, Kaninë*. Kreu studime pasuniversitare në Marburg dhe në Këln (RF e Gjermanisë, 1992, 2000). Nga viti 1985 është anëtar i Institutit Arkeologjik Gjerman (DAI) dhe i Lidhjes së Gazetarëve profesionistë gjermanë. Pedagog i jashtëm në UT dhe në universitetet e qyteteve Marburg dhe Bon (RFGj). Korrespondent dhe gazetar i radios Deutsche Welle dhe i kanalit televiziv publik ZDF të Gjermanisë (1993–1997). Në vitet 1997–1998 i ngarkuar me punë në ambasadën e Shqipërisë në Bon. Kryeredaktor i emisionit shqip në Omni Rogers TV Kanada (2002–2003). Nga vitet 2008-2010 sekretar shkencor i Seksionit të shkencave shoqërore në ASHSH. Drejtor i IMK (2010-2013).

Publikime (Monografi, Vepra kolektive, Përmbledhje studimesh)

Është autor i studimeve:

- “Qyteti në Iliri dhe Epir” (2 vëllime, 2008)

Bashkautor në veprat:

- “Historia e arkitekturës shqiptare” (Tiranë, 1979, maket);
- “Berati, historia dhe arkitektura” (1988,2011);
- “Harta arkeologjike e Shqipërisë” (2008).

Ka botuar një numër artikujsh në revistat shkencore të vendit e të huaja; një varg artikujsh analitikë në shtypin shqiptar e të huaj.

- Autor i librit “Nyja gordiane” (2004).